

**FINMAN sh.p.k**

**“Raporti i Menaxhimit dhe  
Pasqyrat Financiare per vitin  
e mbyllur me 31 Dhjetor 2020”**

PERMBAJTJA

	<b>Faq</b>
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHPERFSHIRESE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	6
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 - 26



**FINMAN sh.p.k**

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2020  
(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Shenime	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
<b>Aktivet</b>			
<i>Aktive afatshkurta</i>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	5	63,961,800	6,729,198
Llogari te arketueshme	6	5,242,658	4,858,695
Parapagim tatim fitimi		473,999	-
Aktiv tatimor i shtyre		2,167,403	-
Te drejta te tjera afatshkurtera	7	24,980,303	255,550,086
Kredi ndaj paleve te lidhura	8	178,738,061	182,762,455
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>275,564,224</b>	<b>449,900,434</b>
<i>Aktive afatgjata</i>			
Aktive afatgjata materiale	9	491,025	405,000
Investime financiare / filiale	10	2,578,059,510	1,765,550,210
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,578,550,535</b>	<b>1,765,955,210</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,854,114,759</b>	<b>2,215,855,644</b>
<i>Detyrime afatshkurta</i>			
Llogarite e pagueshme	11	786,398	715,039
Detyrime te tjera afatshkurtera	12	27,579,998	24,488,371
Hua afatshkurter	13	2,135,652	-
Tatim fitim i pagueshem		-	167,961
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>30,502,049</b>	<b>25,371,371</b>
Hua afatgjate	13	1,089,846	-
Hua nga Aksioneret dhe palet e lidhura	14	-	53,218,000
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>1,089,846</b>	<b>53,218,000</b>
<b>Kapitali aksionar</b>			
Kapitali aksionar	15	90,000,000	90,000,000
Fitimi mbartur		2,047,266,237	41,383,978
Fitimi i vitit		685,256,627	1,633,82,295
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>		<b>2,822,522,864</b>	<b>2,137,266,273</b>
<b>Totali i kapitalit aksionar dhe detyrimeve</b>		<b>2,854,114,759</b>	<b>2,215,855,644</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 26 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

**FINMAN sh.p.k****Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse më 31 Dhjetor 2020***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Te ardhura	16	27,400,400	27,334,852
Te ardhura te tjera		-	-
<b>Te ardhurat Bruto</b>		<b>27,400,400</b>	<b>27,334,852</b>
Kosto e mallrave te shitura/sherbimit te ofruar	17	(1,038,955)	(1,307,439)
Shpenzime personeli	18	(41,190,430)	(19,692,239)
Shpenzime te tjera operative	19	(1,426,779)	(2,884,460)
Zhvleresimi dhe amortizimi	9	(127,300)	-
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(43,783,464)</b>	<b>(23,884,138)</b>
Fitim / (humbja) nga kembimi valutor		1,396,938	(712,480)
Te ardhura / (shpenzime) te tjera financiare		536,773	563,500
<b>Te ardhura financiare neto</b>		<b>1,933,712</b>	<b>(148,980)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>(14,449,352)</b>	<b>3,301,734</b>
Shpenzim tatim mbi fitimin	20	-	(495,260)
(Shpenzime) / E ardhur tatimore e shtyre	20	2,167,403	-
<b>Fitimi neto</b>		<b>(12,281,950)</b>	<b>2,806,474</b>
Te ardhura te tjera gjithepershires		697,538,577	1,631,075,821
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjithepershires</b>		<b>685,256,627</b>	<b>1,633,882,295</b>

*Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershires duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 26 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

**FINMAN sh.p.k****Pasqyra e ndryshimit në kapital më 31 Dhjetor 2020***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

Shënime	Kapitali aksonar	Fitimi mbartur	Fitim / (Humbja ) e Vitit	Totali
Më 01 Janar 2019	90,000,000	413,383,977	-	503,383,977
Fitimi neto	-	-	2,806,474	2,806,474
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	1,631,075,821	1,631,075,821
Më 31 dhjetor 2019	90,000,000	413,383,977	1,633,882,295	2,137,266,272
Më 01 Janar 2020	90,000,000	2,047,266,272	-	2,137,266,272
(Fitimi) / Humbja e periudhës	-	-	(12,281,950)	59,792,081
Rritje kapitali	-	-	-	1,044,550,225
Pagesë dividendi	-	-	-	(1,044,550,225)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	697,538,577	-
Më 31 dhjetor 2020	90,000,000	2,047,266,272	685,256,627	2,822,522,900

*Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shenimet shpjeguese në faqet 7 – 26 që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare.*

**FINMAN sh.p.k****Pasqyra e fluksit të parasë me 31 Dhjetor 2020***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet shfrytezimit:</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>685,256,627</b>	<b>1,633,882,295</b>
<i>Rregullime per shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi	127,300	-
Rritje Interesa	(536,773)	-
Te tjera jomonetare	(2,167,403)	712,480
Fitim / humbje nga kurset e kembimit	1,396,938	-
<i>Ndryshime ne Aktivet dhe Detyrimet e Shfrytezimit</i>		
Renie / (Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	(383,962)	(1,348,771)
Rritje / (Renie) ne aktivet Afatgjata	-	(405,000)
Rritje / (Renie) Te pagueshme per Aktivitetin	71,359	473,233
Renie / (Rritje) ne te pagueshme te tjera	-	17,215,861
Renie / (Rritje) ne Detyrime te tjera Afatshkurtera	1,694,689	946,721
Rritje ne interesat pjesemarrrese	-	(1,648,391,806)
Interesa te (paguara) / arketuara	536,773	-
Tatim fitimi i paguar	(641,960)	-
<b>Mjetet Monetare Neto nga Aktiviteti i Shfrytezimit</b>	<b>685,353,589</b>	<b>3,085,014</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese:</b>		
Para Neto te perdorura per Blerjen e Filialeve	-	(200,000)
Pagesa /Arketime per Blerjen/Shitjen e AAGJ Materiale	(213,325)	-
Pagesa /Arketime per Blerjen/Shitjen e Investimeve te tjera	(1,510,047,877)	(1,592,034,309)
Divident i arketuar / paguar	928,108,360	1,613,423,210
<b>Mjetet Monetare Neto nga Aktiviteti i Investimit</b>	<b>(582,152,842)</b>	<b>21,188,901</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet e financimit</b>		
Kredi te dhena per palet e lidhura	(49,193,606)	(29,590,000)
Pagesa te principalit te huave	(525,348)	-
Disbursim Hua Bankare	(3,750,847)	-
<b>Mjete monetare Neto nga Aktiviteti i Financimit</b>	<b>(45,968,107)</b>	<b>(29,590,000)</b>
<b>Rritje/Renie Neto ne Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet</b>	<b>57,232,639</b>	<b>(5,316,085)</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fillim te vitit</b>	<b>6,729,198</b>	<b>12,260,581</b>
Efekti i Luhatjes nga kursi i kembimit	-	(215,298)
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre ne fund te vitit (shenimi 5)</b>	<b>63,961,837</b>	<b>6,729,198</b>

*Pasqyra e rrjedhes se parase duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 26 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.*

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 janë të miratuara dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

Idajet Ismailaj  
Administrator

Arber Saliaj  
Drejtor i Finances së shoqërisë



## 1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

**FINMAN sh.p.k** u themelua si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 24 Nëntor 2016. Kapitali aksionar më 31 dhjetor 2020 ishte 90,000,000 LEK. **FINMAN sh.p.k** zotërohet 50% nga ortakut Sadik Ismailaj dhe 50% nga ortakut Idajet Ismailaj.

Njësia Ekonomike **FINMAN sh.p.k** ka organizimin si një shoqëri Holding dhe zotëuese e kuotave të disa shoqërive të tjera. Nder aktivitetet e tjera të Finman sh.p.k është dhe të ofrojë asistencë financiare, juridike, organizative, administrative, koordinim teknik në shoqëritë e grupit.

Adresa e zyrave qendrore është në Tiranë, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kulla Binjake numer 2, Kati i pestë. Shoqëria është e regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit me numer NIPT-i L2405030K.

## 2. ZBATIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR TE REJA DHE TE RISHIKUARA (SNRF)

### 2.1 Ndryshimet e reja në standardet ekzistuese efektive për periudhën aktuale të raportimit

Standardet e reja dhe shtesat në standardet aktuale, si më poshtë, të nxjerra nga Bordi i Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit (BSNK) janë në fuqi për periudhën aktuale të raportimit.

- **Ndryshimi i SNK 19: Perfitimet e punonjësve.** Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2019).
- **BSNF ka leshuar Ciklin e Permiresimeve Vjetore të SNRF-ve 2015 - 2017**, i cili është një koleksion i ndryshimeve në SNRF. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2019 me aplikimin e mëparshëm të lejuar.
  - a) **SNK 12 Tatimi mbi të Ardhurat:** Ndryshimet sqarojnë se pasojat e tatimit mbi të ardhurat nga pagesa në instrumente financiare të klasifikuar si kapital, duhet të njihen në përputhje me njohjen e transaksioneve të kaluara ose ngjarjet që kanë gjeneruar fitime të shpërndara.
  - b) **SNK 23 Kostot e Huamarrjes:** Ndryshimet sqarojnë paragrafin 14 të standardit që, kur një aktiv i kualifikuar është gati për përdorim ose shitje, dhe disa nga huamarrjet specifike që lidhen me atë aktiv mbetet i papaguar në atë pike, huamarrja do të përfshihet në fondet që një njësi ekonomike merr hua në përgjithësi.



**2. ZBATIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR TE REJA DHE TE RISHIKUARA (SNRF)**

**2.1 Ndryshimet e reja ne standardet ekzistuese efektive per periudhen aktuale te raportimit (vazhdim)**

- **Ndryshimet ne SNK 28 "Investimet ne Shoqerite dhe Sipermarrjet e Perbashketa"** - Interesat Afatgjate ne Shoqerite dhe Sipermarrjet e Perbashketa
- **Ndryshimet ne standarde te ndryshme per shkak te "Permirosimeve te SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** qe rezultojne nga projekti vjetor i permirosimit te SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qellim heqjen e mosperputhjeve dhe qartesimin e formulimit efektive per periudhat vjetore ).
- **KIRFN 23: Pasiguria mbi Trajtimin e tatimit mbi te ardhurat**  
Interpretimi eshte efektiv per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 janarit 2020 me aplikimin e meparshem te lejuar. Interpretimi adreson kontabilitetin e taksave mbi te ardhurat kur trajtimet tatimore perfshijne pasiguri qe ndikon ne zbatimin e SNK 12. Interpretimi jep udhezime per marrjen ne konsiderate te trajtimeve te pasigurta tatimore vecmas ose se bashku, ekzaminimin nga autoritetet tatimore, metodën e duhur per te pasqyruar pasigurine dhe llogaritjen e ndryshimeve ne fakte dhe rrethana.

Adoptimi i ketyre ndryshimeve ne standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka çuar ne ndonje ndryshim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

**2.2. Standardet e reja dhe ndryshimet ne standardet ekzistuese ne publikim qe nuk jane adoptuar ende**

Ne datën e autorizimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet e reja te meposhtme, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:

- **Ndryshime ne SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Perkufizimi i nje Biznesi (efektiv per kombinime biznesi per te cilat data e blerjes eshte ne ose pas fillimit te periudhes se pare vjetore te raportimit dhe per blerjet e aktiveve qe ndodhin me ose pas fillimit te asaj periudhe).
- **Ndryshime ne SNK 1 dhe SNK8: Perkufizimi per termin Material:** Ne tetor 2018, BSNF publikoi ndryshimet e SNK 1 Prezantimi i Paqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet ne Vleresimet dhe Gabimet e Kontabilitetit per te unifikuar perkufizimin e termit 'material' ne te gjithë standardet dhe per te sqaruar disa aspekte te perkufizimit. Perkufizimi i ri percakton se 'Te dhenat jane materiale nese heqja, paraqitja keq apo fshehja e tyre, ne menyre te arsyeshme do te ndikonte ne vendimet qe perdoruesit per qellime te pergjithshme te pasqyrave financiare do te merrnin duke u bazuar ne ato pasqyra, te cilat paraqesin te dhena financiare per nje shoqeri raportuese'.

Ndryshimet e perkufimit per termin material nuk pritët te kete ndikim te madh ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare", SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiare: Shenimet shpjeguese"** - Reforma e Standardit te Normave te Interesit (efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janarit 2020).
- **Ndryshimet ne SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"** - Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janarit 2022).



**2. ZBATIMI I STANDARDEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR TE REJA DHE TE RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)**

**2.2. Standardet e reja dhe ndryshimet ne standardet ekzistuese ne publikim qe nuk jane adoptuar ende (vazhdim)**

- **SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet ne Vleresimet dhe Gabimet e Kontabilitetit: Perkufizimi i ‘materialit’ (Ndryshimet).** Ndryshimet jane efektive per periudhat vjetore qe fillojne ne ose pas 1 Janarit 2020 me aplikimin e meparshem te lejuar. Ndryshimet sqarojne perkufizimin e materialit dhe menyren e zbatimit te tij. Perkufizimi i ri shprehet se, 'Informacioni eshte material nese perjashtimi, gabimi ose fshehja, ne menyre te arsyeshme pritet te ndikoje ne vendimet qe perdoruesit kryesore te pasqyrave financiare per qellime te pergjithshme bejne mbi bazen e atyre pasqyrave financiare, te cilat ofrojne informacion financiar ne lidhje me nje raportim specifik te entitet '. Per me teper, shpjegimet qe shoqerojne perkufizimin jane permiresuar. Ndryshimet gjithashtu sigurojne qe perkufizimi i materialit te jete ne perputhje me te gjitha Standardet e SNRF-ve.
- **Ndryshimet konceptuale ne Standardet e SNRF-ve te publikuara nga BSNK me 29 mars 2018.** Per shkak te faktit qe Korniza Konceptuale eshte rishikuar, BSNK i ka perditësuar referencat Kornizes Konceptuale ne Standardet e SNRF-ve. Dokumenti permban ndryshime ne SNRF 2, SNRF 3, SNRF 6, SNRF 14, SNK 1, SNK 8, SNK 34, SNK 37, SNK 38, KIRFN 12, KIRFN 19, KIRFN 20, KIRFN 22 dhe KIS-32. Kjo u be per te mbështetur tranzicionin ne Kornizen Konceptuale te rishikuar per shoqerite qe zhvillojne politika kontabel duke perdorur Kornizen Konceptuale kur nuk zbatohet nje Standard i SNRF per nje transaksion te veçante.

Shoqeria ka zgjedhur te mos adoptoje keto standarde te reja, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja perpara dates kur hyjne ne fuqi. Shoqeria parashikon qe adoptimi i ketyre standardeve, ndryshimet ne standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja nuk do te kene ndikim material ne pasqyrat financiare te shoqerise ne periudhen e zbatimit fillestar.

**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL**

**3.1. Perputhshmeria e Pasqyrave**

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK) dhe interpretimi i leshuar nga Komiteti i Interpretimeve te Raportimit Financiar Nderkombetar (KIFRN) i BSNK.

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike.

**3.2. Baza e pergatitjes**

**(a) Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF) te leshuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike.

**(b) Monedha raportuese dhe funksionale**

Keto pasqyra financiare jane pergatitur dhe prezantuar ne monedhen Shqiptare Lek qe eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise. Çdo informacion financiar eshte i paraqitur ne Lek dhe i shprehur ne Lek.

**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel**

Politikat kontabel jane zbatuar ne menyre konsistente per te gjitha periudhat e paraqitura dhe jane te permbledhura me poshte.

**a) Njohja e te ardhurave nga kontratat me klientet**

Shoqeria FINMAN eshte shoqeri HOLDING e cila aktivitetin e saj e kryen ne marredhenie me kompanite e saj bija duke ofruar sherbime te tipit: Konsulence financiare, organizative, menaxheriale, koordinim teknik, juridik etj.

Te ardhurat nga kontratat me klientet njihen kur kontrolli sherbimeve transferohet tek klienti ne nje shume qe reflekton konsideraten ne te cilen Shoqeria pret te kete te drejte ne kembim te atyre sherbimeve.



**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**(a) Njohja e te ardhurave nga kontratat me klientet (vazhdim)**

Kryerja e shërbimeve

Sherbimet e kryera pergjate kohes, duke perdorur metoden e *input-it* per te matur progresin kundrejt plotesimit te sherbimit, sepse klienti merr njekohesisht dhe konsumon benefitet e dhena nga Shoqeria. Te ardhurat nga kontratat e sherbimit njihen duke u referuar fazes se plotesimit te kontrates.

**Zerat kontraktuale**

*Aktiv kontrate*

Nje aktiv i kontrates eshte e drejta per t'u marre ne konsiderate ne kembim te mallrave ose shërbimeve te transferuara te klienti. Nese Shoqeria vepron duke transferuar mallrat apo shërbimet tek nje klient para se klienti te paguaje shumen korresponduese ose para se shuma te jete e detyrueshme per t'u paguar, nje aktiv kontrate njihet te drejten per shumen korresponduese te kushtezuar.

*Te arketueshme tregtare*

Nje e arketueshme tregtare perfaqeson te drejten e Shoqerise per nje shume te konsiderueshme te pakushtezuar (d.m.th., vetem kalimi i kohes kerkohet para se te paguhet pagesa e vleres). Referojuni politikave kontabel te pasurive financiare ne seksionin j) Instrumentet financiare - te arketueshme tregtare- njohja fillestare dhe matja pasuese.

*Detyrim kontrate*

Nje detyrim i kontrates eshte detyrimi per te transferuar mallra ose shërbime nje klienti per te cilin Shoqeria ka marre shumen korrespondueses (ose ka te drejte per nje shume korresponduese) nga klienti. Nese nje klient paguan shumen korresponduesese perpara se Shoqeria te transferoje mallra ose shërbime klientit, nje detyrim kontrate njihet kur pagesa eshte bere ose pagesa eshte per tu paguar (cilado qe eshte me heret). Detyrimet e kontrates njihen si te ardhura kur Shoqeria vepron sipas kontrates.

**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**(a) Njohja e te ardhurave nga kontratat me klientet (vazhdim)**

**Te ardhura te tjera**

Te ardhurat nga interesi

Te ardhurat nga interesat e nje aktivi financiar njihen kur Shoqeria do te kete perfitime ekonomike dhe qe vlera e ketyre te ardhurave mund te matet me besueshmeri. Te ardhurat nga interesat llogariten me baza lineare, duke perdorur principalin dhe nje norme efektive interesi, qe eshte norma e cila aktualizon flukset e ardhshme te pritshme te aktivitetit financiar ne vleren e aktivitetit ne momentin e njohjes fillestare.

**(b) Monedha e huaj**

Transaksionet në monedhe të huaj janë të perkthyer në LEK duke përdorur normat e kembimit të datës së zhvillimit të transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhe të huaj, në datën e raportimit janë perkthyer në monedhën funksionale duke përdorur normën e kembimit të datës. Diferencat që rezultojnë nga kembimi valutës quhen humbje ose fitim nga monedha e huaj. Aktivët dhe detyrimet jo monetare të shprehura në monedhe të huaj, në datën e raportimit janë perkthyer në monedhën funksionale duke përdorur normën e kembimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato aktive të cilat mbahen me vlerën e drejtë janë perkthyer në LEK duke përdorur kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kembimi janë njohur si fitim ose humbje.

Normat e kembimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 sipas Bankës Qendrore të Shqipërisë janë si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
EUR/LEK	123.70	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

Normat mesatare të kembimit për vitin që u mbyll më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 sipas Bankës Qendrore të Shqipërisë janë si më poshtë:

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
EUR/LEK	123.77	123.00
USD/LEK	108.53	109.85

**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**(c) Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perbehet nga tatimi fitimi i periudhes dhe tatimi i shtyre.

Tatimi i periudhes

Tatimi i periudhes eshte i bazuar ne fitimin e tatueshem te vitit. Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi perpara tatimit i paraqitur ne pasqyrat e fitimit dhe humbjes dhe te ardhurave gjithepershireshe per shkak te zerave te ardhurave dhe te shpenzimeve qe jane te tatueshme apo te zbritshem ne vite te tjera dhe zerave qe nuk jane kurre te tatueshem apo te zbritshem. Shpenzimi aktual per tatim llogaritet duke perdorur normen e takses qe eshte ne fuqi ne fund te periudhes raportuese.

Tatimi i shtyre

Tatimi perlllogaritur ( i shtyre) njihet duke paraqitur diferencat e perkohshme midis vlerave kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe vlerave te perdorura per qellime tatimore. Detyrim tatimor i shtyre pergjithesisht njihet per te gjitha diferencat e perkohshme te tatueshme. Nje aktiv tatimor i shtyre njihet pergjithesisht per te gjitha diferencat e perkohshme te zbritshme deri ne masen qe eshte e mundur qe fitimet e tatueshme do te jene ne dispozicion kundrejt te cilave mund te shfrytezohen diferencat e perkohshme te zbritshme. Keto aktive dhe detyrime tatimore te shtyra nuk do te njihen nese diferencat e perkohshme vijne nga njohja fillestare ( pervec kombinimit te biznesit) e aktiveve dhe detyrimeve ne nje transakcion qe nuk ndikon as fitimin e tatueshem as fitimin kontabel.

Vlera e mbetur e aktiveve tatimore te shtyre rishikohen ne çdo date raportimi dhe zvogelohen deri sa nuk jane me te mundshme te realizohen perfitime tatimore te lidhura me te.

Tatimi i shtyre matet me normen tatimore qe pritet te aplikohet ne periudhen qe detyrimi dhe aktivi lindin, duke perdorur normat e tatimeve qe kane hyre ose do te hyjne ne fuqi deri ne daten e raportimit. Matja e tatimit te shtyre reflekton pasojat tatimore qe vijne nga menyra se si Shoqeria pret te rimarre apo te shlyej vleren e aktivit apo detyrimin ne fund te periudhes raportuese.

Tatimi i shtyre dhe aktual vjetor

Tatimi aktual dhe i shtyre do te njihen ne pasqyren e fitimit dhe humbjes, pervecse ne rastet kur jane te lidhur me zera ne te ardhura gjithepershireshe apo direkt me kapitalin, ne kete rast tatimi i shtyre dhe aktual do te njihen direkt ne tabelen e te ardhurave gjithepershireshe apo ne kapital.

**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**(d) Pajisje Kompjuterike dhe Pajisje Zyre**

*(i) Shpenzimet vijuese*

Shpenzimet e zevendesimit te pjeseve te nje aktivi afatgjate kapitalizohen vetem kur ato rrisin perfitimet e ardhshme ekonomike te Shoqerise si dhe vlera e tyre eshte e matshme. Shpenzimet operative njihen ne pasqyren e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave gjithepershireshe ne momentin kur ndodhin.

*(ii) Amortizimi*

Amortizimi vendoset ne tabelen e te ardhurave dhe shpenzimeve duke perdorur metoden lineare per permiresimet e objekteve te marra me qira dhe metoden bazuar mbi vleren e mbetur per te gjitha kategorite e tjera, bazuar ne vleresimin per jetegjatesine per çdo pjese te tokes apo pajisjeve duke u nisur nga dita e pare e muajit deri te muaji i blerjes.

Amortizimi i permiresimeve te ambienteve me qira bazohet mbi periudhen me te shkurter midis kontrates se qirase ose jetegjatesise se permiresimeve siç gjykohet nga Drejtimi. Toka nuk amortizohet. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi. Amortizimi nis kur aktivi eshte gati per ti perdorur ( ne vendin dhe ne kushtet e duhura) dhe mbaron kur aktivi çregjistrohet ose klasifikohet si i mbajtur per shitje.

Normat e amortizimit jane si me poshte:

<b>Aktivi</b>	<b>Perqindja</b>
Pajisje kompjuterike dhe pajisje zyre	25%

esir

### **3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

##### **(e) Zhvleresimi i aktiveve materiale dhe jo materiale**

Ne fund të çdo periudhe raportuese, Shoqëria shqyrton vlerat kontabel të aktiveve të saj materiale dhe jo materiale për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar një humbje nga zhvleresimi. Nëse ekziston një tregues i tillë, vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet shkalla e humbjes nga zhvleresimi (nëse ka). Kur nuk është e mundur të vlerësohet shuma e rikuperueshme e një aktivi individual, Shoqëria vlerëson shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilit i takon aktivi. Kur mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme e alokimit, asetet e Shoqërisë gjithashtu alokohen për njësitë individuale të gjenerimit të mjeteve monetare, ose përndryshe ato u alokohen Shoqërisë me të vogël të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare për të cilat mund të identifikohet një bazë shpërndarjeje e arsyeshme dhe e qëndrueshme.

Shuma e rikuperueshme është vlera me e lartë e vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme të vlerësuar zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë aktualizimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës kohore të parase dhe rreziqet specifike të aktivit për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Nëse shuma e rikuperueshme e një aktivi (ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) vlerësohet të jetë me e vogël se vlera kontabel neto, vlera kontabel neto e aktivit (ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) reduktohet në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvleresimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përveç nëse aktivi përket mbart një shumë të rivlerësuar, në të cilin rast humbja nga zhvleresimi trajtohet si një ulje rivlerësimi.

Kur një humbje nga zhvleresimi me pas anulohet, vlera kontabel (neto) e aktivit (ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) rritet deri në vlerësimin e rishikuar të shumës së rikuperueshme të saj, por në mënyrë që shuma e mbartur nuk tejkalon vlerën kontabel që do të ishte përcaktuar nëse nuk kishte njohur humbje nga zhvleresimi për aktivin (ose njësinë gjeneruese të mjeteve monetare) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga zhvleresimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përveç nëse aktivi përket mbart një shumë të rivlerësuar, në të cilin rast shlyerja e humbjes nga zhvleresimi trajtohet si një rritje rivlerësimi.

### **3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

#### **3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

##### **(h) Instrumentet financiare**

##### **Njohja dhe matja fillestare**

Instrumentet financiare klasifikohen, ne njohjen fillestare, me pas maten me koston e amortizuar.

Klasifikimi i instrumenteve financiare ne njohjen fillestare varet nga karakteristikat e fluksit monetar te instrumentit financiar dhe modeli i biznesit te Shoqerise per administrimin e tyre. Te arketueshmet tregtare nuk permbajne nje komponent te rendesishem financimi dhe maten me çmimin e transaksionit te percaktuar ne SNRF 15. Referojuni politikave te kontabilitetit ne seksionin a) Te ardhurat nga kontratat me klientet.

Ne menyre qe nje instrument financiar i borxhit te klasifikohet dhe matet me koston e amortizuar, duhet te krijoje fluks parash qe jane "vetem pagesa te principalit dhe interesit (VPPI)" mbi vleren e mbetur pa paguar. Ky vleresim quhet testi VPPI dhe kryhet ne nje nivel instrumentesh.

##### **Matja pas njohjes fillestare**

Shoqeria mat mjetet financiare me kosto te amortizuar nese plotesohen te dyja kushtet e meposhtme:

- Aktivi financiar mbahet me nje modeli biznesi me qellim mbajtjen e aktiveve financiare per te mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale te aktivitetit financiar lindin ne data te specifikuar te fluksit te parave qe jane vetem pagesa te principalit dhe interesit mbi shumen e mbetur pa paguar.

Aktivitetet financiare me kosto te amortizuar me pas maten duke perdorur metoden e interesit efektiv (EIR) dhe zhvleresimit. Fitimet dhe humbjet njihen ne fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvleresohet.

Aktivitetet financiare te Shoqerise me kosto te amortizuar perfshijne vetem te arketueshme tregtare.



**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**(i) Instrumentet financiare (vazhdim)**

*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perbehen nga para ne arke, llogarite rrjedhese bankare dhe investime afatshkurtra me likuiditet te larte te cilat kane maturitet tre muaj ose me pak.

*Llogarite e pagueshme*

Llogarite e pagueshme fillimisht njihen me vleren e drejte dhe ne vazhdimesi maten me koston e amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

*Huate*

Pas njohjes fillestare, huate qe mbartin interes regjistrohen me kosto te amortizuar me çdo diference midis koston dhe vleres se rimarrjes dhe njihet ne fitim ose humbje gjate periudhes se huamarrjes mbi bazen e interesit efektiv.

*Vlera e drejte*

Vlera e drejte e llogaritur e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve, llogarive te arketueshme, llogarive te pagueshme dhe huave eshte e ngjashme me vleren e tyre kontabel.

**(j) Shpenzimet**

Shoqeria synon te njohe shpenzimet ne pasqyren e te ardhurave permbledhese ne perpjesetim me kohen e sherbimeve te kryera ne daten e raportimit. Shpenzimet qe lidhen me disa periudha kontabel shtyhen ne periudhat e ardhshme ne te njejten kohe kur lindin te ardhura.

**(k) Perfitimet e punonjesve**

Gjate ecurise normale te biznesit, Shoqeria ben pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve per kontributet e detyrueshme te pagave sipas legjislacionit vendor. Keto kosto te kryera ne emer te Shoqerise, jane te paraqitura ne pasqyren permbledhese te te ardhurave ne momentin e ndodhjes.

Punonjesit e Shoqerise jane anetare te planit te pensionit te shtetit shqiptar. Shoqeria nuk operon ndonje skeme tjeter te pensioneve ose skeme per perfitime pas pensionit dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnje detyrim ne lidhje me pensionet. Gjithashtu Shoqeria nuk eshte e detyruar te ofroje perfitime te metejshme per punonjesit aktuale dhe te meparshem.

**(l) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat nga financimi perfshijne te ardhurat nga interesat per shumat e investuara ne depozita bankare dhe fitimet ne valute. Te ardhurat nga interesi njihen kur realizohet, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit per huate, humbjet ne valute, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes (nese ka), dhe humbjet nga zhvleresimi te njohura ne aktivet financiare. Te gjitha koston e huamarrjes njihen ne pasqyren e performances duke perdorur metoden e interesit efektiv.

**(m) Dividendet**

Shoqeria njihet dividendet si detyrime kur ato deklarohen.

**3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL (VAZHDIM)**

**3.3. Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**(n) Informacioni krahasues**

Informacioni krahasues paraqitet vazhdimisht duke zbatuar politikat kontabel te Shoqerise. Kur eshte e nevojshme, shuma te caktuara ne vitin paraprak jane riklasifikuar ne perputhje me prezantimin e vitit aktual.

**GJYKIMI KRITIK KONTABEL DHE BURIMET KYÇE PER VLERESIMIN E PASIGURIESE**

Shoqeria pergatit pasqyrat e saj financiare ne perputhje me SNRF-te, zbatimi i te cilave shpesh kerkon qe gjykimet te behen nga menaxhimi gjate ndertimit te pasqyrave financiare te Shoqerise. Sipas SNRF-se, menaxhimi kerkohet qe te zbatoje keto politika kontabel ne menyren me te pershtatshme per rrethanat e Shoqerise me qellim qe te paraqesin ne menyre te drejte pozicionin financiar te Shoqerise, performancen financiare dhe flukset e mjeteve monetare.

Ne percaktimin dhe zbatimin e politikave kontabel, gjykimi shpesh kerkohet ne lidhje me zerat ku zgjedhja e politikave specifike, vleresimit kontabel ose supozimi qe duhet te ndiqet mund te ndikojte materialisht ne rezultatet e raportuara ose poziten neto te aktiveve te Shoqerise, atehere me vone duhet te percaktohet nje tjetër zgjedhje me e pershtatshme.

Menaxhimi merr ne konsiderate vleresimet e kontabilitetit dhe nje supozim te diskutuar me poshte si vleresimet e tij kontabel kritike dhe, ne perputhje me rrethanat, jep nje shpjegim per secilen me poshte.

## FINMAN sh.p.k

### Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

(Shumat janë të shprehura në LEK)

#### MJETET MONETARE DHE EKVALENTET

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë si me poshte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Llogari rrjedhese ne banke</b>		
EUR	1,857,857	2,192,821
LEK	61,934,299	4,346,742
USD	169,603	189,594
<b>Totali i llogarive rrjedhese ne banke</b>	<b>63,961,759</b>	<b>6,729,156</b>
<b>Para ne arke</b>		
EUR	-	-
LEK	-	-
<b>Totali i parave ne arke</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>63,961,759</b>	<b>6,729,156</b>

#### 4. LLOGARI TE ARKETUESHME

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kliente	5,242,658	4,858,695
Te drejta te tjera	24,980,303	255,550,086
<b>Totali</b>	<b>30,222,961</b>	<b>260,408,781</b>

Llogari te arketueshme Kliente perbehen nga levizja afatshkurter e fondeve midis paleve te lidhura. Llogari te arketueshme Te drejta te tjera perbehen nga Dividenti i arketueshem i shoqerive te kontrolluara.

#### 5. PARAPAGIME

Parapagimet perfaqesojne pagesat e bera ndaj furnitoreve kryesisht te lidhura me blerjen e pjeseve te kembimit te aktiveve fikse dhe te mjeteve fikse.

**FINMAN sh.p.k****Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020***(Shumat janë të shprehura në LEK)***6. PAJISJE KOMPJUTERIKE DHE PAJISJE ZYRE**

Pajisjet kompjuterike dhe Pajisjet e Zyres me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 perbehen si me poshte:

E drejta e  
perdorimit te  
aktiveve (SNRF  
16)

	Makineri	Pajisje te ndryshme	Automjete	Pajisje kompjuterike	Pajisje zyre	Totali
<b>Kosto</b>						
Me 01 Janar 2020	-	-	-	405,000	-	405,000
Shtesa	-	-	-	130,658	82,667	213,325
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	-	-	-	535,658	82,667	618,325
<b>Amortizimi akumuluar</b>						
Me 01 Janar 2020	-	-	-	-	-	-
Shpenzimi i vitit	-	-	-	(119,033)	(8,267)	(127,300)
Pakesime	-	-	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	-	-	-	(119,033)	(8,267)	(127,300)
<b>Vlera kontabel</b>						
Me 31 dhjetor 2019	-	-	-	405,000	-	405,000
Me 31 dhjetor 2020	-	-	-	416,625	74,400	491,025

**FINMAN sh.p.k****Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020***(Shumat janë të shprehura në LEK)***7. LLOGARITE E PAGUESHME**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Llogarite e pagueshme ndaj furnitoreve	786,398	715,039
<b>Totali</b>	<b>786,398</b>	<b>715,039</b>

**8. TE ARDHURA TE SHTYRA**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Te ardhura te shtyra	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**9. DETYRIME TE TJERA**

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pagat dhe shperblimet	1,427,876	1,251,566
Sigurimi social i pagueshem	910,756	297,566
Tatimi mbi Pagen	4,109,063	361,609
Detyrime te tjera ndaj punonjesve	77,519	10,000
TVSH e pagueshme	451,623	480,381
Kapital i nenshkruar i papaguar	20,603,161	22,086,861
<b>Totali</b>	<b>27,579,998</b>	<b>24,488,371</b>

**10. HUATE**

Me 03 Qershor 2020, Shoqeria ka hyre ne nje marreveshje kredie, me vlere prej 3,749,976, me Banken OTP ALBANIA sha. Per arsye se aktiviteti i shoqerise u ndikua nga pasojat e COVID 19, Finman shpk ju drejtua Bankes OTP duke u bazuar ne Garancine Shteterore sipas Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 277 dt. 04.06.2020 "Per miratimin e garancise shteterore te huase me bankat e nivelit te dyte per pagat e tregtareve ose shoqerive tregtare, aktiviteti i te cilave eshte prekur nga vendimet e Keshillit te Ministrave, ne kuader te menaxhimit te situates se krijuar nga COVID 19, si dhe per percaktimin e kushteve e te kriterereve te marreveshjes se garancise dhe marreveshjes se mirekuptimit".

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
HUA nga Bankat	3,225,499	-
Hua nga Aksioneret	-	53,218,000
<b>Totali</b>	<b>3,225,499</b>	<b>53,218,000</b>

**11. KAPITALI AKSIONAR**

Shoqeria është në pronësi 50% nga ortakët Sadik Ismailaj dhe 50% nga ortakët Idajet Ismailaj. Kapitali aksionar më 31 dhjetor 2020 është 90.000.000 LEK.

**12. TE ARDHURAT**

Te ardhurat nga veprimtaria operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë të detajuara në tabelën e mëposhtme:

	Viti që mbyllet më 31 Dhjetor 2020	Viti që mbyllet më 31 Dhjetor 2019
Te ardhura nga shërbimet	27,400,400	27,334,852
Te ardhura nga produktet e shitura	-	-
Shitje mallrash	-	-
<b>Totali</b>	<b>27,400,400</b>	<b>27,34,852</b>

**FINMAN sh.p.k****Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020***(Shumat janë të shprehura në LEK)***13. KOSTO E MALLRAVE TE SHITURA / SHERBIMIT TE OFRUAR**

	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2020	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2019
Kostoja e mallit te shitur / sherbimit te ofruar	1,038,955	1,307,439
Te tjera ne koston e mallrave te shitura	-	-
Pagat dhe kompensimet	-	-
Sigurimi social dhe shendetesor	-	-
Kostoja e energjise elektrike	-	-
<b>Totali</b>	<b>1,038,955</b>	<b>1,307,439</b>

**14. SHPENZIME PERSONELI**

	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2020	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2019
<b>Te perfshira ne koston e shpenzimeve administrative:</b>		
Pagat dhe kompensimet	37,399,390	17,846,891
Sigurimi social dhe shendetesor	2,492,405	1,765,348
Shpenzime te tjera lidhur me personelin	1,298,635	80,000
<b>Totali</b>	<b>41,190,430</b>	<b>19,692,239</b>

**15. SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE**

	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2020	Viti qe mbyllet me 31 dhjetor 2019
Shpenzime transporti	155,820	-
Taksa e tatime te tjera	74,500	67,000
Shpenzime te tjera administrative	175,213	-
Shpenzime Qiraje	347,967	221,696
Konsulence	362,324	5,200
Komisione Bankare	105,013	95,165
Publicitet dhe Marketing	-	2,495,400
Sherbime postare dhe telefonike	208,942	-
<b>Totali</b>	<b>1,426,779</b>	<b>2,884,460</b>

**16. TATIMI MBI FITIMIN**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri me një normë të tatimit mbi të ardhurat prej 15%. Formularet e deklaratave tatimore dorëzohen çdo vit. Të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore konsiderohen si një auto deklaratë derisa ato të shqyrtohen dhe vlerësohen nga autoritetet tatimore. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë subjekt i interpretimit nga autoritetet tatimore.

Llogaritja e shpenzimeve të tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 është paraqitur më poshtë:

	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2020	Viti që mbyllet më 31 dhjetor 2019
<b>Fitimi i vitit para tatimit</b>	<b>(14,449,352)</b>	<b>3,301,734</b>
<i>Shpenzime jo të zbritshme</i>		
Tjeter	-	-
Provizion për borxhin e keq	-	-
<b>Fitim i tatueshem</b>	<b>(14,449,352)</b>	<b>3,301,734</b>
<b>(Shpenzime) / E ardhur tatimore</b>	<b>2,167,403</b>	<b>(495,260)</b>

Shoqëria rezulton me Aktiv Tatimor të Shtyre në vlerën: 2,167,403 LEK



**17. TRANSAKSIONE ME PALE TE LIDHURA**

Nje pale eshte pale e lidhur nese: **(a)** ne menyre direkt apo indirekt pala: (i) eshte nje parti qe kontrollon, qe kontrollohet ose qe eshte nen te njejten pronesi (kjo perfshin memen dhe filialet); (ii) nese ka nje interes ne njesine ekonomike qe i jep ndikim domethenes mbi njesine ekonomike; ose (iii) nese ka kontroll te perbashket mbi njesine ekonomike; **(b)** eshte nje njesi ekonomike e lidhur; **(c)** eshte nje ndermarrje e perbashket; **(d)** apo eshte anetar i personelit drejtues kryesor te njesise ekonomike ose meme se saj; **(e)** duke perfshire edhe anetaret e familjes se ngushte te ndonje prej personave te permendur me lart; **(f)** eshte nje parti qe kontrollohet ose ndikohet ne menyre domethenese ose ka kontroll mbi votat ne menyre direkte ose indirekte, nga ndonje nga individet e permendur ne (d) ose (e); **(g)** eshte nje parti per nje plan perfitimi pas punesimit per punonjesit e njesise ekonomike ose te cilesdo pale te lidhur te njesise ekonomike.

Transaksionet me palet e lidhura paraqesin nje transferim te burimeve, sherbimeve apo detyrimeve ndermjet paleve te lidhura, pavaresisht nese eshte vene nje çmim.

Nje permbledhje e transaksioneve me palet e lidhura eshte si me poshte:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Aktive</b>		
Llogari te arketueshme	5,241,220	4,858,695
<i>Nga shoqeri te lidhura</i>		
Alb-Star sh.p.k	4,156,320	1,826,549
Vibtis sh.p.k	259,770	1,461,240
Asab sh.p.k	222,660	73,062
APM sh.p.k	111,330	949,806
Ecoclean sh.a	285,923	61,616
Albrail sh.p.k	-	437,289
AOS sh.a	-	36,531
AM Rentals sh.p.k	132,254	12,603
 <i>Interesa Pjesemarrrese ne Njesi Ekonomike</i>		
AOS sh.a	24,980,303	-
Vibtis sh.p.k	-	255,550,086
<b>Aktive totale nga pale te lidhura</b>	<b>30,221,523</b>	<b>260,408,781</b>
 <b>Detyrime</b>		
Llogari te pagueshme		
<i>Nga shoqeri te lidhura:</i>		
Alb-Star sh.p.k	60,000	18,266
<b>Detyrime totale nga pale te lidhura</b>	<b>60,000</b>	<b>18,266</b>

Ne “Llogari te arketueshme Nga shoqeri Te lidhura” paraqiten te pasqyruara faturat e papaguara per shitjet qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit (tepricat e klienteve), si dhe tepricat debitore te marredhenieve me furnitoret.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikohet renie ne vlere.

**18. PREZANTIMI I VLERES SE DREJTE**

Menaxhimi i Shoqërisë vlerëson që në datën e raportimit vlera e drejte e instrumenteve financiare është afërsisht sa vlera kontabel e tyre.

**19. ANGAZHIME DHE PASIGURI**

*Pretendime ligjore*

Gjatë aktivitetit normal, Shoqëria mund të jetë subjekt i kërkesave të ndryshme ligjore. Me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk ka pretendime ligjore në pritje.

**20. Menaxhimi i kapitalit**

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë investitorët, kreditorët dhe besimin e tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit.

**21. NGJARJE PAS DATES SE RAPORTIMIT**

Koronavirusi po shqetëson ekonominë botërore. Ai ka ngadalesuar mbarevajtjen normale të punës. Pavarësisht shpërthimit të COVID 19, vazhdueshmëria e aktivitetit të Shoqërisë FINMAN sh.p.k nuk rrezikohet. Shoqëria vlerëson se nuk ka paqartësi ekonomike apo ndonjë rrezik në lidhje me aktivitetin e saj.

Asnjë ngjarje tjetër e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

